



Projekti: Zhvillimi i Sistemeve të Besueshme dhe Funkzionale të Policive si dhe Inkurajimi i Luftimit të Aktiviteteve Kryesore Kriminale dhe i Bashkëpunimit ndërmjet Policive (Projekti CARPO)
Fokusi: Fuqizimi i kapaciteteve të policive kundër krimeve të rënda në Evropën Juglindore

Takim i nivelit të lartë i Ministrave të Brendshëm dhe i Zyrtarëve të Lartë të vendeve të Evropës Juglindore mbi Strategjinë Rajonale dhe Instrumentet kundër Krimin të Organizuar dhe Krimin Ekonomik
(Ishulli Brijuni, Kroaci, 23 Shtator 2005)

PRAPAVIJA DHE JUSTIFIKIMI

Vitet e fundit, vendet e Evropës Juglindore kanë bërë një progres domethënës në drejtim të pranimit të instrumenteve të ndryshme evropiane dhe ndërkombëtare, në përjasjen e legjislacionit të tyre, në krijimin e institucioneve të specializuara për luftimin e krimin ekonomik, pastrimin e parave, korrupsionin dhe krimin e organizuar si dhe në miratimin e politikave dhe strategjive në disa prej këtyre fushave.

Duke patur parasysh implikimet ndërkufitare dhe ndërkombëtare të krimin të organizuar dhe krimin ekonomik, masat e marra në nivel kombëtar, duhet të plotësohen me strategji rajonale dhe ndërkombëtare. Vendet e Evropës Juglindore e kanë pranuar këtë dhe kanë marrë pjesë për disa vite në nisma të ndryshme rajonale dhe programe kundër krimin të organizuar dhe korrupsionit. Megjithatë, dimensionin rajonal dhe ndërkombëtar duhet të thellohet më tej. Miratimi i një strategjie rajonale mbi instrumentet kundër krimin të organizuar dhe krimin ekonomik është një vlerë e mëtejshme në këtë drejtim.

Përpunimi i kësaj strategjie është mbështetur nga Projekti CARPO i Komisionit Evropian dhe Këshillit të Evropës dhe mbulon sektorët e mëposhtëm:

- Analiza e krimin dhe e të dhënave mbi krimin
- Hetimi financiar dhe konfiskimi i produkteve të krimin
- Mjetet e posaçme hetimore
- Mbrojtja e dëshmitarit
- Bashkëpunimi në fushën penale.

Strategjitë që janë hartuar për secilin nga këta sektorë deri më tani, do të duhet të përmbledhen në një strategji rajonale të konsoliduar.

Projekti CARPO u ka dhënë mundësinë të gjitha vendeve pjesëmarrëse nga Evropa Juglindore (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Serbia dhe Mali i Zi dhe “Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë”), që janë anëtare të Këshillit të Evropës dhe që bëjnë përpjekje për t’u afruar me Bashkimin Evropian, të përkufizojnë disa parametra të përbashkët për të vlerësuar progresin e bërë në raport me standardet e Këshillit të Evropës dhe *acquis* e Bashkimit Evropian.

OBJEKTIVI

Mbledhja e nivelit të lartë e Ministrave të Brendshëm dhe e Zyrtarëve të Lartë në Brijuni ka si qëllim të vlerësojë progresin e arritur në luftën kundër krimin të organizuar në Evropën Juglindore, sikurse dhe të shqyrtojë Strategjinë Rajonale mbi Instrumentet kundër Krimin të Organizuar dhe Krimin Ekonomik, që është përgatitur nga zyrtarët e këtyre vendeve, në bazë të projektit CARPO. Strategjia rajonale do të garantojë një përjasje metodologjike si dhe aksione të përbashkëta në Evropën Juglindore, duke u mbështetur tek:

- Një raport mbi gjendjen e krimit të organizuar dhe krimit ekonomik në rajon,
- Parametrat e përbashkët të vendosur për të matur progresin e bërë nga secila zone e projektit, në drejtim të afrimit me *acquis* e Bashkimit Evropian dhe standardet e Këshillit të Evropës,
- Strategjitë sipas sektorëve mbi analizën e krimit dhe të dhënave të krimit, hetimin financiar dhe konfiskimin e produkteve të krimit, mjetet e posaçme hetimore, mbrojtjen e dëshmitarit dhe bashkëpunimin në fushën penale.
- Strategjitë kombëtare ekzistuese

NDERTIMI I MBLEDHJES

Mbledhja do të ndahet në dy pjesë:

- 22 shtator: Mbledhja e ekspertëve për të finalizuar Strategjinë Rajonale dhe Deklaratën e Përbashkët.
- 23 shtator: Mbledhja e nivelit të lartë e Ministrave të Brendshëm dhe e Zyrtarëve të Lartë nga Evropa Juglindore mbi Strategjinë Rajonale dhe Instrumentet kundër Krimit të Organizuar dhe Krimit Ekonomik.

REZULTATET E PRITSHME

Mbledhja e nivelit të lartë e Ministrave të Brendshëm dhe të zyrtarëve të lartë do t'i paraprijë marrëveshjes mbi një Strategji Rajonale të gjithanshme dhe legjitime mbi Instrumentet kundër Krimit të Organizuar dhe Krimit Ekonomik, e cila do të shërbejë edhe si bazë për plan-veprimet e posaçme që do të ndërmerren në vendet pjesëmarrëse. Ministrat e Brendshëm si dhe Zyrtarët e Lartë do të kenë gjithashtu mundësinë të nënshkruajnë deklaratën e përbashkët.

PJESËMARRËSIT

Ministrat e Brendshëm dhe zyrtarë të lartë nga autoritetet qendrore të gjyqësorit dhe të zbatimit të ligjit, përgjegjës për çështjet që kanë lidhje me krimin e organizuar dhe krimin ekonomik nga: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Serbia dhe Mali I Zi, “Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë” dhe nga UNMIK-u.

Përfaqësues të grupeve teknike të punës nga vendet dhe zonat pjesëmarrëse në projekt.

Përfaqësues të Këshillit të Evropës, Komisionit Evropian, partnerët e konsorciumit të projektit: Belgjika, Finlanda, Hungaria, Italia, Sllovenia, Spanja, Suedia, Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM).

Vëzhgues: Europol, Eurojust, Misioni i OSBE-së në Kroaci, SPOC and UNODC.

Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve pritet të jetë rreth 100 persona.

PËR ÇDO INFORMACION SHITESË JU LUTEM KONTAKTONI:

Këshilli i Evropës, DG I – Çështjet Juridike, Departamenti i Problemeve të Krimit:

☎ Jean-Charles de Cordes

Tel. + 33-3-9021-5305 - Fax + 33-3-8841-2052 - ✉: jean-charles.decordes@coe.int

☎ Livia Stoica -Becht

Tel. + 33-3-9021-4260 - Fax + 33-3-8841-2052 - ✉: livia.stoica@coe.int

Në Kroaci :

☎ Tamara Karaica

Tel. +385-1-4816-887 - Fax +385-1-4816-879 - ✉: tamara.karaica@coe.int